



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.154

19 nëntor

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.727, datë 30.10.2007	Për një shtesë në vendimin nr.87, datë 15.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për administrimin dhe mbulimin e shpenzimeve të recetës me rimbursim”	4495
Vendim i KM nr.731, datë 7.11.2007	Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve	4495
Vendim i KM nr.733, datë 7.11.2007	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shtetit të Izraelit, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, të shërbimit dhe të zakonshme	4496
Vendim i KM nr.736, datë 7.11.2007	Për miratimin, në parim, të kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI), për financimin e projektit të rrugës Levan-Vlorë	4498
Vendim i KM nr.737, datë 7.11.2007	Për miratimin, në parim, të marrëveshjes së huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për financimin e projektit të rrugës Levan-Vlorë	4498
Vendim i KM nr.738, datë 7.11.2007	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Fushë-Krujë të qarkut të Durrësit	4499
Vendim i KM nr.739, datë 7.11.2007	Për miratimin në parim të Marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike	4500

Vendim i KM nr.742, datë 7.11.2007	Për kriteret e përzgjedhjes së njësive ekonomike, që duhet të zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.....	4501
Vendim i KM nr.752, datë 7.11.2007	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.....	4502
Udhëzim i MF nr.22, datë 9.11.2007	Për disa shtesa në udhëzimin e Ministrit të Financave nr.3, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”	4502
Vendim i ERE nr.59, datë 29.10.2007	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të “OST” sh.a. për llogaritjen e tarifave të shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2008-2010	4503
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Pëllumb Qamil File Malko	4503

VENDIM
Nr.727, datë 30.10.2007

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.87, DATË 15.2.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ADMINISTRIMIN DHE MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË RECETËS
ME RIMBURSIM”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 36 të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.87, datë 15.2.2006 të Këshillit të Ministrave, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Përfshihen nga pagesa e kësaj tarife të siguruarit, që me ligj ose akt nënligjor të veçantë, përfitojnë mjekim me barna falas.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.731, datë 7.11.2007

PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTËVE TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË VLERËSIMIT
VJETOR, INDIVIDUAL, PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 e 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve, sipas viteve, të jenë si më poshtë vijon:

Për vitin 2006	1.00;
Për vitin 2005	1.02;
Për vitin 2004	1.12;
Për vitin 2003	1.10;
Për vitin 2002	1.09;
Për vitin 2001	1.14;
Për vitin 2000	1.07;
Për vitin 1999	1.09;
Për vitin 1998	1.05;
Për vitin 1997	1.22;
Për vitin 1996	1.09;
Për vitin 1995	1.37;
Për vitin 1994	1.32.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, janë vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga 1.1.2007 dhe përballohen nga buxheti i vitit 2007, miratuar për Institutin

e Sigurimeve Shoqërore.

3. Vendimi nr.400, datë 21.6.2006 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.733, datë 7.11.2007

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË IZRAELIT, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, TË SHËRBIMIT DHE TË ZAKONSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Izraelit, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, të shërbimit dhe të zakonshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË IZRAELIT MBI HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, TË SHËRBIMIT DHE TË ZAKONSHME

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shtetit të Izraelit (këtu quhen “Palët”):

me dëshirën për të zhvilluar më tej marrëdhëniet miqësore që ekzistojnë ndërmjet dy vendeve; në përpjekje për të lehtësuar procedurat e udhëtimit për shtetasit e të dy vendeve, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shtetasit e secilës Palë, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike, të shërbimit ose të zakonshme, përjashtohen nga detyrimi për marrjen e vizës me qëllim hyrjen në territorin e Palës tjetër për një vizitë ose qëndrim që nuk i kalon nëntëdhjetë (90) ditë brenda gjashtë (6) muajve nga data e hyrjes së parë.

Neni 2

Shtetasve të secilit vend, që kanë ndër mend të qëndrojnë në territorin e vendit tjetër për një periudhë që i kalon nëntëdhjetë (90) ditë, u kërkohet të pajisen paraprakisht me viza.

Neni 3

Shtetasve të secilit vend, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit, që ushtrojnë funksione zyrtare në vendin tjetër si anëtarë të një personeli diplomatik ose konsullor me qëndrim në territorin e Palës tjetër dhe të afërmeve të tyre që janë pjesë e familjeve të tyre, u kërkohet të pajisen me vizë tridhjetë (30) ditë nga data e hyrjes. Vizat e përmendura në këtë nen janë të vlefshme për periudhën e caktimit të tyre.

Neni 4

Vizat e përmendura në nenet 2-3 të kësaj Marrëveshjeje lëshohen falas nga misioni diplomatik ose konsullor i vendit përkatës.

Neni 5

Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme kuptohet që qytetarët shqiptarë që hyjnë në Izrael dhe qytetarët izraelitë që hyjnë në Shqipëri nuk janë të përjashtuar nga detyrimi për të respektuar ligjet dhe rregulloret e brendshme në lidhje me hyrjen, qëndrimin dhe punësimin apo profesionin për të huajt.

Neni 6

Secila Palë rezervon të drejtën të mos lejojë hyrjen për shtetasit e Palës tjetër, që ajo mund t'i konsiderojë të padëshirueshëm apo të shkurtojë periudhën e qëndrimit për këta shtetas.

Neni 7

1. Palët shkëmbejnë ekzemplarë të pasaportave të tyre të vlefshme nëpërmjet kanaleve diplomatike jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Nëse një Palë lëshon një model të ri të një pasaporte apo modifikon ato që janë shkëmbyer, Pala tjetër njoftohet për këto modifikime nëpërmjet kanaleve diplomatike tridhjetë (30) ditë para datës së hyrjes në fuqi të pasaportave të reja apo të modifikimeve. Njoftimi përfshin një ekzemplar të dokumenteve të reja apo të modifikuara dhe informacionin për zbatueshmërinë e tyre.

Neni 8

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi për një periudhë fillestare prej një viti, nëntëdhjetë (90) ditë nga data e notës së dytë të notave diplomatike nëpërmjet të cilave Palët njoftojnë njëra-tjetrën që procedurat e brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes janë respektuar. Kjo Marrëveshje zgjatet automatikisht për periudha shtesë prej një viti secila.

2. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi derisa një Palë njofton tjetrën nëpërmjet një note diplomatike në lidhje me synimin e saj për ta përfunduar atë, të paktën nëntëdhjetë (90) ditë para datës së përfundimit të synuar.

Neni 9

Shkëmbimi i notave të datës 28 nëntor 1993, që përbëjnë një Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Shtetit të Izraelit dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në lidhje me heqjen e kërkesave për vizë për mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, shfuqizohet në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Nënshkruar në Tiranë, më 22 tetor 2007, që përputhet me ditën.....5768 në hebraisht,

shqip dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentikë. Në rast mospërputhjeje në interpretim, mbizotëron teksti në anglisht.

VENDIM
Nr.736, datë 7.11.2007

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË KONTRATËS FINANCIARE, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE (BEI),
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RRUGËS LEVAN-VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 26 të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin në parim të kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI), për financimin e projektit të rrugës Levan-Vlorë, në shumën prej 23 000 000 (njëzet e tre milionë) eurosh.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.737, datë 7.11.2007

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË HUASË, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM (BERZH), PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RRUGËS LEVAN-VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 26 të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të Marrëveshjes së huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për financimin e projektit të rrugës Levan-Vlorë, në shumën prej 22 000 000 (njëzet e dy milionë) eurosh.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.738, datë 7.11.2007

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË
FUSHË-KRUJË TË QARKUT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes

4498

vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Fushë-Krujë të qarkut të Durrësit, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Fushë-Krujë të qarkut të Durrësit, miratuar me vendimin nr.670, datë 4.10.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Fushë-Krujës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Fushë-Krujës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Fushë-Krujë

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-10	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
11	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
12-150, 152-188	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës (troje)	Në përdorim
189-193	Varrezat publike	Në pronësi
194-225, 365-377, 379-422, 424-609, 611-629, 631-676, 678-772, 774-788, 790-872, 876-888	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore)	Në pronësi
228	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
229-308	Prona që përdoren në fushën e pyjeve dhe kullotave	Në pronësi
309-314, 315, 318-326	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
316, 317, 327, 328, 342, 346, 352, 356, 361	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
226	Prona që përdoren në fushën e strehimit	Në pronësi
151, 392, 329, 330, 313,	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi

VENDIM
Nr.739, datë 7.11.2007

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES ME SHKËMBIM NOTASH,
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
JAPONISË, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE
DIPLOMATIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 6 e 14 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin në parim të marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

NOTË VERBALE

Ministria e Punëve të Jashtme i paraqet komplimentet e saj Ambasadës së Republikës së Shqipërisë dhe ka nderin ta informojë këtë të fundit, se Qeveria e Japonisë është e përgatitur të ndërmarrë, mbi baza reciproke, masat e mëposhtme nga 10 dhjetor 2007 lidhur me kërkesën për heqjen e kërkesave për vizë.

1. Shtetasit e Republikës së Shqipërisë mbajtës së pasaportave të vlefshme diplomatike, të lëshuara nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë, që kërkojnë të hyjnë në Japoni me qëllim që të ushtrojnë funksionet diplomatike ose konsullore të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe shtetasit që mbajnë pasaportat e lartpërmendura, të cilët janë anëtarë të familjeve të tyre, pjesëtarë respektiv të tyre, mund të hyjnë në Japoni pa pasur vizë, pavarësisht nga kohëzgjatja e qëndrimit të tyre në Japoni.

2.1) Shtetasit e Republikës së Shqipërisë mbajtës së pasaportave të vlefshme diplomatike, të lëshuara nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë, që kërkojnë të hyjnë në Japoni për qëllime të tjera, të ndryshme nga ato të referuara në paragrafin 1 dhe me qëllim qëndrimin në Japoni për një periudhë që nuk i kalon nëntëdhjetë (90) ditë në vazhdimësi, mund të hyjnë në Japoni pa vizë.

2) Heqja e kërkesave për vizë sipas nënparagrafit (1), më sipër, nuk do të zbatohet për ata shtetas të Republikës së Shqipërisë të cilët dëshirojnë të hyjnë në Japoni me qëllim të kërkimit të punësimit, qëndrimit të përhershëm ose të ushtrimit të profesionit, ose ndonjë punësimi tjetër (duke përfshirë zbatimin publike dhe sportet për qëllime përfitimi).

3) Heqja e kërkesës për vizë sipas paragrafit 1 dhe 2, më sipër nuk përjashton shtetasit e Republikës së Shqipërisë që hyjnë në Japoni nga detyrimi për t’u bindur ligjeve dhe rregullave të Japonisë lidhur me hyrjen, qëndrimin, rezidencën, daljen dhe kontrolle të tjera për të huajt.

4) Qeveria e Japonisë rezervon të drejtën për të pezulluar përkohësisht zbatimin e të gjitha ose disa masave të mëparshme për arsye të politikës publike, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me sigurinë publike, rregullin dhe shëndetin. Çdo pezullim ose heqje e pezullimit do të njoftohet menjëherë te Qeveria e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet kanaleve diplomatike.

5) Qeveria e Japonisë rezervon të drejtën për të refuzuar hyrjen ose qëndrimin në Japoni për ata shtetas të Republikës së Shqipërisë të konsideruar të padëshiruar pa paraqitur motivet për vendimin e saj.

6. Qeveria e Japonisë mund të përfundojë masat e mëparshme duke dhënë më parë, një shënim me shkrim 30-ditor për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë.

Ministria e Punëve të Jashtme përfiton nga ky rast t’i përsërisë Ambasadës së Republikës së

Shqipërisë sigurimet e konsideratës më të lartë.
Tokio, (muaji, data, viti)

VENDIM
Nr.742, datë 7.11.2007

**PËR KRITERET E PËRZGJEDHJES SË NJËSIVE EKONOMIKE, QË DUHET TË
ZBATOJNË STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË KONTABILITETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c” të pikës 3 të nenit 4 të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Subjekte të zbatimit të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit janë subjektet e përcaktuara në pikën 3 të nenit 4 të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar.

2. Njësitë e tjera ekonomike, të cilat nuk janë objekt i ligjit të sipërpërmendur, do të jenë subjekt i zbatimit të standardeve ndërkombëtare, kur tejkalojnë njëkohësisht, për dy vitet e fundit, këto kufij:

a) të ardhurat vjetore, në shumën 1 250 000 000 (një miliard e dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë;

b) numri mesatar i të punësuarve, mbi 100 punonjës në vit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit për mbikëqyrjen e zbatimit të pikës 2 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.752, datë 7.11.2007

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 8 e 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në buxhetin e miratuar për vitin 2007,

në programin “Mbështetje për zhvillim ekonomik”, zëri “Shpenzime kapitale të brendshme”, t’i shtohet fondi prej 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekësh.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.22, datë 9.11.2007

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË FINANCAVE NR.3, DATË 30.1.2006
“PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës dhe në zbatim të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në fund të pikës 9.1 “Libri i shitjeve”, shtohet një paragraf me përmbajtje përsa më poshtë vijon:

“Tatimpaguesit që deklarojnë dhe paguajnë TVSH-në në mënyrë elektronike duhet të dërgojnë në degën e tatimeve kopje elektronike të regjistrimeve mujore në librin e blerjeve.”.

2. Në fund të pikës 9.2 “Libri i shitjeve”, shtohet një paragraf me përmbajtje përsa më poshtë vijon:

“Tatimpaguesit që deklarojnë dhe paguajnë TVSH-në në mënyrë elektronike duhet të dërgojnë në degën e tatimeve kopje elektronike të regjistrimeve mujore në librin e shitjeve.”.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

VENDIM
Nr.59, datë 29.10.2007

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË OST SHA PËR
LLOGARITJEN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR PERIU DHËN 2008-2010

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26, pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s” neni 18, dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.59, datë 29.12.2004 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike“, pika 9.2, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 29.10.2007, pasi shqyrtoi aplikimin për llogaritjen e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria “OST” sh.a. për periudhën 2008-2010,

VENDOSI:

Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për llogaritjen e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria “OST” sh.a. për periudhën 2008-2010.

Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Bujar Nepravishta

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr.964, datë 8.10.2007, shpall të zhdukur shtetasin Pëllumb Qamil File Malko, i datëlindjes 25.4.1963, lindur dhe banues në Zharrec, bashkia Divjakë, Lushnjë.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. REGJISTRAT E NOTERISË
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PUNËS

KODI I FAMILJES

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat

Hyri në shtyp më 19.11.2007
Doli nga shtypi më 19.11.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
Tiranë, 2007

Çmimi 12 lekë